

VENDIM
Nr.3, datë 11.3.2011

PËR SHPËRNDARJEN E FONDEVE TË ZHVILLIMIT TË RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Financimin prej 3 354 856 007 (tre miliardë e treqind e pesëdhjetë e katër milionë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatë) lekësh, pjesë e fondit të buxhetit të vitit 2011 për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve, për projektet e reja të aplikuara nga njësitë e qeverisjes vendore, universitetet dhe bordet e kullimit në shumat si më poshtë vijon:

- Vlerën prej 1 445 775 548 (një miliard e katërqind e dyzet e pesë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e dyzet e tetë) lekësh për infrastrukturën rrugore, specifikuar sipas listës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Vlerën prej 146 789 896 (njëqind e dyzet e gjashtë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, specifikuar sipas listës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Vlerën prej 34 586 256 (tridhjetë e katër milionë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekësh për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, specifikuar sipas listës nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Vlerën prej 310 000 000 (treqind e dhjetë milionë) lekësh për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, specifikuar sipas listës nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Vlerën prej 927 231 801 (nëntëqind e njëzet e shtatë milionë e dyqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e një) lekësh për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, specifikuar sipas listës nr.5, në nivel programi buxhetor, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Vlerën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh për Ministrinë e Shëndetësisë, specifikuar sipas listës nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Vlerën prej 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekësh për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, specifikuar sipas listës nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Financimin prej 240 472 506 (dyqind e dyzet milionë e katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e gjashtë) lekësh të projekteve në qarqet Kukës, Dibër, Elbasan dhe Berat në fushat e ujësjellës-kanalizimeve, arsimit, shëndetësisë dhe trashëgimisë kulturore nëpërmjet financimit të PNUD, shoqëruar me bashkëfinancimin në vlerën prej 99 018 092 (nëntëdhjetë e nëntë milionë e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy) lekë, specifikuar sipas listës nr.8, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Financave të kryejë veprimet për bërjen efektive të fondeve.

KRYETARI
Sali Berisha